

FUNKSIONET LIGJËRIMORE TË PASVENDOSJES SË FJALISË SË VARUR KOHORE

Dr. Erjon Agolli

Departamenti i Gjuhës Angleze
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: agollierjon@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Fjalitë kohore të pasvendosura zakonisht diktojnë një model komunikimi me shkëmbime të shpeshta të radhës së bisedës midis bashkëbiseduesve. Ndryshe nga fjalitë kohore të paravendosura, të cilat mund ta shtrijnë referencën e tyre si në kontekstin që e paraprin, ashtu edhe në atë që e pason periudhën ku ato bëjnë pjesë, fjalitë kohore të pasvendosura zakonisht kanë aktivitet të kufizuar brenda kufijve të periudhës. Gjithsesi, kjo nuk do të thotë se ato janë plotësisht të zhveshura nga funksionet ligjërimore. Duke qenë se këto fjali tregojnë përfundim mendimi, ato njëkohësisht sinjalizojnë edhe kalimin e radhës së bisedës nga një folës tek tjetri. Për më tepër, fjalitë kohore të pasvendosura kryejnë edhe funksione korrigjuese në ligjërim, të cilat sigurisht që mund të trajtohen përmes ballafaqimit sintaksor-semantik-pragmatik. Pra, në këtë punim do të arrijmë në përfundimin se, fjalitë kohore të pasvendosura nuk kanë gjithmonë funksion të lokalizuar brenda periudhës, por ato mund të krijojnë lidhje edhe me kontekstin që i paraprin duke kontribuar në koherencën dhe kohezionin e bisedës.

Fjalët çelës: fjali kohore, e pasvendosur, funksione ligjërimore

ABSTRACT

Time clauses in final position usually dictate frequent turn-taking of interlocutors in a conversation. Unlike time clauses in initial position, which extend their reference onto the context preceding and/or following the complex sentence they are part of, time clauses in final position usually have a limited activity within the boundaries of the complex sentence. However, this doesn't mean that they are completely devoid of any discourse functions. Because these clauses denote completion of thought, they simultaneously signal the exchange of turn from one speaker to the other participant/s in the conversation. What is more, time clauses in final position also play corrective functions in discourse, which can definitely be treated through the syntax-semantics-pragmatics interface. Thus, as we are going to conclude in this paper, time clauses in final position do not always play an exclusive local function in a complex sentence, instead they can create ties with the preceding context contributing to the coherence and cohesion of the conversation.

Keywords: time clause, final position, discourse functions

Hyrje

Ky punim shkencor¹ përqendrohet te veçoritë sintaksore, semantike e pragmatike të pasvendosjes së fjalive të varura kohore në stilin bisedor të gjuhës angleze. Në gjuhën e folur është shumë e vështirë të flasim për një stil të unifikuar brenda llojit, sidomos kur bëhet fjalë për biseda të natyrshme, pa skenar, të realizuara nga njerëz të ndryshëm që flasin në mënyra të ndryshme me dialektet e idiolektet e tyre. Por, pikërisht, e gjithë kjo mori nënstylesh e nënvariantesh krijon një bashkësi rregullash dhe jorregullash që përbëjnë tiparet dalluese të stilit bisedor.

Sipas Miller-it, fjalitë e varura në ligjërimin bisedor të paplanifikuar janë më të thjeshta sesa në gjuhën e shkruar të planifikuar. Thjeshtësia e fjalive të varura në stilin bisedor lidhet me përdorimin e togfjalëshave emërorë të thjeshtë, por edhe kjo varet nga folësi (folësit që kanë lexuar shumë prodhojnë gjuhë të ndërlikuar në ligjërimin bisedor) dhe konteksti (sa më zyrtar të jetë konteksti, aq më e ndërlikuar është gjuha).² Të këtij mendimi janë edhe Quaglio-ja dhe Biber-i kur analizojnë tiparet gramatikore tipike të stilit bisedor që reflektohen në përdorimin e dendur të fjalive të varura kohore të shkurtra e të thjeshta, p.sh. foljet, ndajfoljet dhe përemrat³.

Nga ana tjetër, ka gjuhëtarë si Halliday⁴ dhe Pu-ja⁵ që mendojnë se tiparet e ligjërimin bisedor nuk lidhen aq shumë me thjeshtësinë e periudhës ose të fjalisë së varur sesa me mënyrën se si folësit e paraqesin informacionin dhe ngjarjet. Ka dhe gjuhëtarë si McCarthy e Carter-i që mendojnë se folësit rregullisht bëjnë zgjedhje gramatikore të cilat reflektojnë natyrën ndërvepruese dhe ndërpersonale të komunikimit, gjë e cila përligj përdorimin e shpeshtë të pyetjeve, si dhe të formave të shkurtuara dhe elipsës⁶. Gjuhëtarët e anglishtes i njohin stilit bisedor disa tipare të përgjithshme, si përdorimin e shpeshtë të përemrave, mungesën

1 (për më tepër shiko) Agolli, E. *Studim krahasues mbi periudhën me fjali të varur kohore në anglisht dhe shqip*, punim për gradën shkencore «Doktor».

2 Miller, J. *Clause Structure in Spoken Discourse*. Elsevier, 2006, ff. 481-483.

3 Quaglio, P. & Biber, D. *The Grammar of Conversation*. The Handbook of English Linguistics, Edited by Bas Aarts, Blackwell Publishing, Oksford, 2006, ff. 692-723.

4 Halliday, M. A. K. *Spoken and written language*. Oxford University Press, Oksford, 1989.

5 Pu, M. M. *Spoken and Written Narratives: A Comparative Study*. Journal of Chinese Language and Computing, Vol. 16, No. 1, ff. 37-61.

6 McCarthy, M. and Carter, R. *Spoken grammar: what is it and how can we teach it?* ELT Journal 49 (3), 1995, ff. 207-18.

e rrjedhshmërisë për shkak të ngurrimeve, ndreqjeve e përsëritjeve, si dhe karakteristikat fonologjike e akustike⁷.

Sigurisht qëllimi ynë nuk është të nxjerrim në pah tipare stilistikore të ligjërimit bisedor në përgjithësi, por vetëm ato tipare gjuhësore-stilistikore që lidhen me pasvendosjen e fjalive të varura kohore në këtë stil. Prandaj, në brendësi të këtij artikulli do të trajtohen funksionet ligjërimore të pasvendosjes së fjalisë së varur kohore, për të nxjerrë në dritë gjetje të reja interesante në lidhje me këto struktura.

Metodologjia

Të gjithë shembujt që kemi përdorur për të analizuar periudhat me fjali të varur kohore në stilin bisedor janë mbledhur nga dy korpusë masive, përkatësisht, nga anglishtja britanike kemi shfrytëzuar *British National Corpus*⁸ (Korpusi Kombëtar Britanik), ndërsa nga anglishtja amerikane *Corpus of Contemporary American English*⁹ (Korpusi i Anglishtes Amerikane Bashkëkohore). I pari (BNC) është një korpus i krijuar gjatë periudhës 1991-1994, me botimin e tij të tretë në 2007, dhe përmban 100 milionë fjalë. Nga ana tjetër COCA, që është një korpus i hapur për publikun në internet, njihet si korpusi më i madh i anglishtes amerikane me plot 450 milionë fjalë të grumbulluara gjatë periudhës 1990-2012.

Sigurisht, nga të dy korpuset kemi përdorur vetëm nënndarjen përkatëse të stilit bisedor nga rubrika e gjuhës së folur, nga ku kemi marrë një kampion prej rreth 100000 fjalësh. Ky korpus përbëhet prej 250 periudhash me fjali të varur kohore nga BNC dhe 200 periudhash me fjali të varur kohore nga COCA. Të dhënat e korpusit janë përpunuar me kujdes dhe janë studiuar me hollësi për të nxjerrë në dritë veçoritë dhe tiparet dalluese të periudhave me fjali të varur kohore në stilin bisedor. Por, gjithsesi, duhet theksuar se gjetjet gjatë analizës janë të lidhura ngushtë me korpusin që kemi marrë në shqyrtim.

7 Jurafsky, D. & Martin, J. H. *Speech and Language Processing: An Introduction to Natural Language Processing, Computational Linguistics and Speech Recognition*. Second Edition, Pearson Prentice Hall, Nju-Xhersi, 2006.

8 British National Corpus. BNC XML Third Edition, Oxford University Computing Services, Oksford, 2007.

9 Corpus of Contemporary American English. Created by Mark Davies, Brigham Young University, Utah, 2012.

1. Plotësimi i informacionit dhe mbyllja e radhës në bisedë

Gjatë vëzhgimit të hollësishëm të korpuseve (BNC and COCA) që kemi marrë në shqyrtim për analizën e periudhave me fjali të varur kohore në stilin bisedor, kemi vërejtur se fjalitë kohore të pasvendosura shpesh shërbejnë për të plotësuar jo vetëm përmbajtjen kuptimore të fjalisë kryesore, por edhe për të plotësuar ligjëratën e një folësi me informacion të rëndësishëm. I tillë është shembulli që vijon, ku fjalja e varur kohore e pasvendosur jep informacion të genësishëm me vlerë përtej kufijve të periudhës, pjesë e së cilës ajo është:

Shembulli 1

A: But I just got one thing that I want, that they gon na send me owt dodgy like a loan shark bloke or owt like that, I mean you, you're bound to be a bit nervous, you know.

B: No, they won't send a loan shark. You you can tell loan sharks, straight away, because the **A P R**'s about twenty seven per cent. Ma—maybe twenty nine, even thirty, depending, but if it er, mind you I don't know, because it's a long time ***since I had a look at' em***. But, you know, *when you when you borrow money*, you get er, an interest rate, don't you, over so many, yo-- you've got to figure out ho-- how many years you're gon na pay it back... (BNC)

Bashkëbiseduesit po flasin për kreditë bankare dhe normat e interesit. Fjalja e varur kohore ***since I had a look at' em*** (që kur i hodha një sy) mbart të gjithë informacionin kryesor dhe fjalja kryesore ***it's a long time*** (ka kaluar shumë kohë) në fakt shpreh vetëm përcaktimin kohor. Nëse do të përmysej marrëdhënia sintaksore fjalja kohore do të kthehej në fjali të mëvetësishme, dhe fjalja kryesore në rrethanor kohe ***I had a look at them a long time ago***. (***I hodha një sy shumë kohë më parë***). Pra, këtu fjalja e varur kohore merr një rol mjaft të rëndësishëm në plotësimin e informacionit në periudhë dhe njëkohësisht jep një arsye pse folësi nuk i mban mend me saktësi normat e interesit, që përmenden më herët në bisedë.

Megjithëse në bisedën e mësipërme kemi një kalim nga një kornizë kohore në tjetrën, duhet theksuar që fjalitë kohore të pasvendosura nuk mund të ndikojnë në zhvendosjen e sfondit kohor të bisedës. Kjo është një veçori që u përket

vetëm fjalive kohore të paravendosura. Në të vërtetë, në shembullin në fjalë këtë zhvendosje e bën folësi B me anë të fjalisë kohore të paravendosur **when you borrow money** (kur merr para hua).

Shembulli i mëposhtëm nxjerr në pah një funksion të mirëfilltë ligjërimor të fjalive kohore të pasvendosura në kuadrin e funksioneve ndërvepruese dhe të administrimit të bisedës. Më konkretisht, fjalitë kohore të pasvendosura, duke nënkuptuar plotësimin e informacionit dhe përfundimin e mendimit, shpesh japin sinjale të qarta për bashkëbiseduesin që të marrë fjalën:

Shembulli 2

A: For one thing, I could beat Nancy with my skating. I was ready. I was in the best shape of my life. I was landing triple Axel. I had beaten her before. I was ready. I was skating in the morning; I was skating at night; I was ready for that competition. The only reason why he did this is because he found out that I was going to leave him **as soon as I was done going to nationals**.

B: Had you made that very clear to him?

A: No.

B: How did he find out?

A: Somebody from the rink told him... (COCA)

Në fillim të bisedës folësj A po argumenton se mund të dilte e para në kampionatin e patinazhit, por ish-bashkëshorti i saj u bë pengesë për këtë gjë qëllimisht, pasi e kishte marrë vesh që ajo do ta linte. Dhe me anë të fjalisë kohore të pasvendosur **as soon as I was done going to nationals** (sapo të hiqja dorë nga kampionatet kombëtare), A-ja plotëson arsyetimin e saj duke përcaktuar edhe kohën se kur kishte ndërmend të divorcohej prej tij. Përfundimi i mendimit me anë të fjalisë kohore të pasvendosur, si dhe elemente të tjera të komunikimit, si intonacioni, pauzat etj., sinjalizojnë qartësisht që folësj A e ka mbyllur radhën e fjalës dhe është momenti për folësin B që të ndërhyjë.

Përveç funksionit organizues të përmendur më sipër, fjalitë kohore të pasvendosura (kuptohet në raste më të rralla se fjalitë kohore të paravendosura), mund të kryejnë funksion koheziv, duke krijuar lidhje me pjesën e ligjërimorit që i paraprin periudhës ku ato bëjnë pjesë. Kjo arrihet jo thjesht me anë të

rimarrjes së një elementi të përmendur në kontekstin paraprirës, por me anë të një ndërvarësie kuptimore që krijohet midis fjalisë kohore dhe përmbajtjes kuptimore të fjalive në kontekstin e mësipërm:

Shembulli 3

A: ... You didn't go straight from college overseas.

B: Well, as near as possible because, erm, I mean I was appointed to, to Africa while I was still in college.

A: Oh, mm, mm ...

B: But then there was delay because of war conditions ...


A: Mm, mm ...

B: ... so ... so it was nearly a year *before we actually got away*.

A: aha ...

B: In the end I took a, a ... (BNC)

Shembulli i mësipërm përforcon edhe njëherë argumentin që fjalia e varur kohore e pasvendosur nuk shërben thjesht për të plotësuar kuptimin e fjalisë kryesore. Përkundrazi, fjalia e varur kohore *before we actually got away* (para se të largoheshim vërtet) lidhet aq ngushtë me kontekstin e mëparshëm, saqë nuk do të kishte kuptim jashtë tij. Më konkretisht, kuptimi i fjalisë kohore del qartë vetëm nëse kemi parasysh që në kontekstin që i paraprin periudhës me fjali të varur kohore folësi thotë që e caktuan me punë në Afrikë, por më pas largimi i tij drejt Afrikës u vonua për shkak të luftës dhe u desh të kalonte një vit para se ai të largohej vërtet. Le ta shohim këtë interpretim të ilustruar më poshtë:



2. Saktësimi i një shprehjeje kohore

Në stilin bisedor fjalitë e varura kohore të pasvendosura shpesh shërbejnë edhe për të specifikuar ose saktësuar një fjalë, shprehje apo fjali që shpreh kuptim të përgjithshëm kohor. Këtu nuk kemi të bëjmë me fjali përcaktore (*relative clause*) që përcakton një fjalë ose togfjalësh me kuptim kohor, por me një lloj të veçantë fjalish kohore që shtohen pas një rrethanori kohe ose një fjalie tjetër kohore për të qartësuar më mirë rrethanat kohore në periudhë.

Bashkëngjitja e një fjalie kohore përbën kështu një veçori për ligjërimin bisedor. Ndryshe nga gjuha e shkruar, ku fjalitë e paragrafët paraqiten më të rregullt dhe të organizuar, pasi personi që shkruan ka gjithë kohën e nevojshme për ta menduar e rimenduar formulimin e fjalisë, por edhe për ta ndryshuar e përshtatur atë para se t'i japë formën përfundimtare, në stilin bisedor folësit, duke mos e planifikuar paraprakisht se çfarë do të thonë e se si do të shprehen, në momente të caktuara, detyrohen të bëjnë ndërhyrje qartësuese ose saktësuese në mënyrë spontane. Në të vërtetë, në shembullin që vijon, ndërhyrja me anë të fjalisë kohore të pasvendosur është aq spontane, sa folësi e krijon fjalinë aty për aty duke bërë ndryshimet e nevojshme; në fillim përdor foljen *had* dhe më pas e zëvendëson atë me *used to live*. Ndryshimi vazhdon edhe në pjesën e fundit të fjalisë së varur kohore, ku në fillim folësi përdor parafjalën *at (në) at Southwold* dhe më pas *near (pranë) near Southwold*, duke i dhënë fjalisë kohore kuptimin përfundimtar ***when I used to live near Southwold*** (kur jetoja pranë Southwold):

Shembulli 4

A: Very peaceful too, down, down there.

B: ...since I was round there ... cos it was the fifties when I was there. Oh, I've been with Joyce since then, ***when I ...had ... used to live at Southwold, or near Southwold***, ... and eh, we used to go there and she, she got killed where all the ..., she had a, a garden wall of felt sort of Fred Flintstone one, and there was a bend on the Ipswich erm, oh Ipswich Lowestoft road, right where she had this cottage...

A: Oh yeah.

B: ... and some car came through out of control, went straight into the wall, the wall collapsed on ... (BNC)

Duket që rrethanori i kohës *since then* (që atëherë) shpreh rrethana të paqarta kohore që kanë nevojë të saktësohen më tej. Në korpus kemi gjetur shumë shembuj të tillë, ndaj më poshtë po paraqesim vetëm disa shkurtimisht për ta bërë sa më të qartë dallimin midis këtyre fjalive kohore të veçanta për stilin bisedor dhe fjalive përcaktore kohore:

Shembulli 5

a. Are they gon na give it us **then**, **when** they've got it?

(Do të na'i japin **atëherë**, **kur ta kenë**?)

b. Don't come off **then**, **when** you get in the car.

(Mos zbrit **atëherë**, **kur të hipësh në makinë**.)

Në gjuhën e shkruar këto fjali me siguri do të kishin një paraqitje tjetër. Me shumë gjasë, do të hiqej shprehja me kuptim të përgjithshëm kohor *then*, pasi ajo nuk ka ndonjë vlerë të qenësishme kuptimore, për sa i përket përcaktimit të rrethanave kohore në fjali. Në këto kushte periodhat me fjali kohore më sipër do të kishin këtë formë:

Shembulli 6

a. Are they gon na give it us **when** they've got it?

(Do të na i japin **kur ta kenë**?)

b. Don't come off **when** you get in the car.

(Mos zbrit **kur të hipësh në makinë**.)

Në shembullin që vijon bashkëngjitja e fjalisë së varur kohore është e detyrueshme jo vetëm në aspektin semantik, por edhe në atë gramatikor, pasi fjalia kryesore nuk mund të qëndrojë pa fjalinë e varur kohore. Sado paradoksale të duket kjo, në rastin e mëposhtëm fjalia kryesore **that was one I came across for the first time** (atë e hasa për herë të parë) nuk gëzon pavarësi të plotë nga fjalia e varur kohore **when I came into Suffolk** (kur erdha në Suffolk):

Shembulli 7

A: Th--, it's a dialect word really.

B: Oh not erm, not a spadge Yo—er

C: No.

B: I heard the name spadge when I was ...

A: No, it would be spud wouldn't it?

C: Yeah.

A: It's probably in the dialect book, I haven't looked it up...

B: ...I'm rather...

A: And another good old word is the crome, now er *that was one I came across for the first time **when I came into Suffolk***, the crome. I jolly soon learnt what a crome was, I didn't ask I waited to find out... (BNC)

Në kontekstin e mësipërm bashkëbiseduesit po flasin për fjalë dialektore ose të vjetra që nuk i kishin dëgjuar ndonjëherë. Folësi A thotë se e hasi një fjalë për herë të parë kur erdhi në Suffolk. Shprehja *for the first time (për herë të parë)* në këtë fjali kërkon të shoqërohet patjetër me një pikë kohore në të shkuarën, në mënyrë që kuptimi i saj të plotësohet. Në këto kushte fjalia e varur kohore kryen funksion saktësues që është thelbësor për periudhën në fjalë.

Në stilin bisedor janë të shumta edhe rastet kur një fjali e varur kohore i bashkëngjitet një fjali tjetër të varur kohore që i paraprin. Në këto struktura fjalia e dytë kohore ka funksion saktësues ose specifikues për informacionin kohor të fjalisë së varur kohore që i paraprin asaj:

Shembulli 8

A: ... I mean, she works in ... huge offices doesn't she?

B: Yes. It's the biggest ... erm ... fraud er o... well civil service outside London.

A: Yeah. Right... There was erm ... what I thought was a, a white Rolls ... parked outside our house ***when I was putting the washing on the line*** just ***after you went to work***... (BNC)

Fjalia e parë kohore ***when I was putting the washing on the line*** (kur po nderja rrobat), përbën një referencë të qartë kohore për vetë folësin A, por jo për folësin B,

pasi ky i fundit nuk e di se kur po i nderte rrobat A-ja. Gjithçka qartësohet për B-në kur A-ja shton fjalinë tjetër kohore **after you went to work** (pasi ike për në punë).

3. Korrigjimi i mangësive në ligjërim

Siç e kemi përmendur më herët në këtë pjesë, stili bisedor duke qenë spontan në natyrën e vet karakterizohet nga gabime të shumta gramatikore, pauza, përsëritje, ngurrime, ose mungesë rrjedhshmërie në ligjërim. Për të shprehur informacion kohor folësit mund të zgjedhin fillimisht një strukturë gramatikore, më pas e ndërrojnë me një tjetër që u duket më e përshtatshme sipas nevojës për të arritur një komunikim të suksesshëm. Sigurisht, me interes për ne është të shohim se si fjalitë e varura kohore të pasvendosura përdoren për të riparuar ose ndrequr këto “defekte” që janë tipike për gjuhën e folur, ndaj në vijim do të ndalemi tek disa raste që e ilustrojnë këtë funksion:

Shembulli 9

A: ...You know what's so interesting, I was saying *when I was*, you know, *watching* ... you know, **when we all watch you** and also when you just even see just a little bit of clip, it's that your timing is impeccable, and you were sa ... don't you notice just the ... the timing?

B: Yeah.

A: You can't pay for that. I don't know. How do you get that?

B: By listening, I think... (COCA)

Biseda e mësipërme jep prova të funksionit korrigjues të fjalive të varura kohore të pasvendosura në momentin e një mungese rrjedhshmërie të folëses A gjatë paraqitjes së informacionit kohor në ligjërimin e saj. A-ja po përshkruan se çfarë i kishte lënë më tepër mbresa nga gatimi i folëses B. Mungesa e rrjedhshmërisë vjen pasi fjalja e varur kohore është formuluar pjesërisht **when I was, you know, watching ...** (kur unë, e ke parasysh, po shikoja...) dhe më pas korrigjohet menjëherë në you know, **when we all watch you** (e ke parasysh, kur ne të gjithë të shohim ty). Kështu, folësja A e ndryshon formën e kësaj fjalie kohore duke zëvendësuar kryefjalën nga I në We all, për të përfshirë të gjithë pjesëtarët

e familjes, dhe kohën foljore nga *was watching* në *watch*, për të nënkuptuar një veprim me vlerë mbarëkohore. Pra, një interpretim i mundshëm i këtij korrigjimi është se folësja A do t'i tregojë kuzhinieres së famshme se emisionet e saj ndiqen regullisht në familjen e saj.

Ky lloj funksioni korrigjues është karakteristik për fjalitë e varura kohore të pasvendosura në stilin bisedor, ndaj e shohim me vend të paraqesim edhe dy raste të tjera tipike. Tek (10) folësja A po shpjegon se pse ia vuri vajzës së vet emrin Ana:

Shembulli 10

A: I know ... beca ... that's only cos we were going to ... call her Lisa Marie ... weren't we?

B: Oh I don't know ...

A: We were gon na call her Lisa Marie ... but then ... I said ... Bernie said that because mum done so much for me during... ar... **when I was pregnant with Ricky** an... all the rest of it and called her Anna Marie, after mum... (BNC)

Folësja A fillon ta japë informacionin kohor me anë të një rrethanori kompleks kohe me parafjalën *during* (*gjatë*). E braktis menjëherë këtë strukturë për të përdorur një fjali të varur kohore me lidhëzën *when* (*kur*). Mendojmë se në këtë rast ndryshimi i strukturës është bërë për arsye tërësisht stilistikore, pasi **when I was pregnant with Ricky** (*kur isha shtatzënë me Rikun*) është më e përshtatshme për stilin bisedor informal sesa **during my pregnancy with Ricky** (*gjatë shtatzënësisë sime me Rikun*), që tingëllon shumë formale.

Edhe shembulli i fundit i kushtohet funksionit korrigjues të fjalive të varura kohore të pasvendosura, por këtë herë kemi të bëjmë me një “defekt” të brendshëm të fjalisë kohore, i cili bëhet shkak edhe për një përsëritje të panevojshme që dëmton rrjedhshmërinë e bisedës:

Shembulli 11


A: Do you. Do you have er young boys at your school? Do they have to do all your bidding and fetching and carrying and things?

B: No. They used to but they don't any more they've taken all that sort of brilliant stuff away. But they did **that** to me *when I was their age* **and now** as soon as I get to fourteen **when when you can, when you can, when you could do that ... And now** today ... it's not fair.

A: Mm... No it's probably ... right that you don't bully the youngsters. (BNC)

Në këtë bisedë folësi B po flet për problemet me djemtë e tjerë më të rritur në shkollë, duke përshkruar se si kur ishte më i vogël ata e urdhëronin dhe e ngacmonin. Në fjalinë kohore që i referohet pikërisht kësaj kohe në të shkuarën, B-ja gabimisht përdor formën e tashme në vend të formës së shkuar të foljes modale *can*, të cilën e korrigjon në variantin e tretë të fjalisë kohore në fjalë **when when** you can, when you can, when you could do that (*kur mund ta bësh, kur mund ta bësh, kur mund ta bëje këtë*).

Në fakt, ky shembull na sjell në vëmendje një tjetër problem me fjalitë e varura kohore të pasvendosura në stilin bisedor: atë të vendosjes së këtyre fjalive në vendin e gabuar në periudhë. Fjalial kohore e mësipërme është në rrafshin e së shkuarës, ndërsa fjalial e saj kryesore është në rrafshin e së tashmes. Këtë zhvendosje të sfondit kohor folësi e ka bërë me anë të rrethanorit të kohës *now (tani)* dhe fjalial kohore me lidhëzën *as soon as* **and now as soon as I get to fourteen** (*sapo të mbush katërmëdhjetë*). Prandaj, fjalial kohore **when you could do that** (*kur mund ta bëje këtë*), nga pikëpamja kohore, tematike dhe kuptimore e ka vendin pas fjalisë tjetër kohore **when I was their age** (*kur isha në moshën e këtyre*), pasi ajo tregon një situatë në të shkuarën, kur mund të ndodhnin veprimet që B-ja përshkruan në bisedë, e jo tani që ai po mbush 14 vjeç. Me fjalë të tjera, mund të themi se folësi B ka bërë një ndërhyrje për të shtuar një sqarim të rrethanave kohore. Kjo vërtetohet edhe nga pauza e gjatë që e pason këtë fjali dhe përsëritja e të njëjtit rrethanor kohe *now (tani)*, i cili e rikthen bisedën në rrafshin e së tashmes pas kësaj ndërhyrjeje. Për ta pasur më të qartë, le ta ilustrojmë më poshtë këtë periudhë:



Këto vendosje të gabuara ndodhin përsëri për shkak të lirshmërisë që të ofron stili bisedor për të shtuar një mendim pa sjellë keqkuptime, edhe pse në momentin dhe vendin e gabuar në ligjëratë. Në të vërtetë, në këtë ekstrakt mesazhi i folësit B nënkuptohet duke marrë parasysh kontekstin, por edhe karakteristikat e stilit bisedor, kur bëhet fjalë për tolerimin e mangësive të tilla.

Përfundime

Si përfundim, le të kujtojmë edhe njëherë shkurtimisht funksionet ligjërimore që kryejnë fjalitë e varura kohore të pasvendosura në gjuhën angleze. Në fjalinë e thjeshtë në gjuhën angleze paraqitja e rrethanave kohore përgjithësisht bëhet në fund të fjalisë, pasi janë sqaruar rrethanat e tjera si mënyra, vendi etj. Po kështu edhe në periudhë, kur fjalia e varur kohore vendoset pas fjalisë kryesore, ajo nënkupton plotësim të informacionit dhe përfundim të mendimit, duke sinjalizuar mbyllje të radhës së fjalës në bisedë. Ky është një funksion i mirëfilltë organizues që e udhëzon bashkëbiseduesin për vazhdimësinë e bisedës, por fjalitë e varura kohore mund të krijojnë lidhje edhe me kontekstin paraprirës dhe të kryejnë kështu funksion koheziv. Gjatë analizës së korpusit zbuluam një dukuri të veçantë që nuk e kemi hasur në stilin letrar ose në atë gazetaresk. Bëhet fjalë për bashkëngjitjen e një fjalie të varur kohore pas një rrethanori kohe ose pas një fjalie tjetër kohore. Në këto raste kemi të bëjmë me ndërhyrje spontane për të shtuar një detaj të nevojshëm kohor, që do t'i saktësonte më mirë rrethanat kohore në periudhë. Së fundi, pasvendosja e fjalisë së varur kohore mund të kryejë edhe funksion riparues në bisedë, duke ndrequr gabime gramatikore, përsëritje ose thjesht ngurtime të folësit.

BIBLIOGRAFIA:

- AGOLLI, E. (2015) *Studim krahasues mbi periudhën me fjali të varur kohore në anglisht dhe shqip*, punim për gradën shkencore «Doktor»
- BERK, M.-L. (1999), *English Syntax from Word to Discourse*. Oxford University Press, Nju Jork.
- BIBER, D. (2011), Johansson, S., Leech, G., Conrad, S. & Finegan, E., *Longman Grammar of Spoken and Written English*. Pearson Education Limited, Londër.
- BEOWN, G.Y. (1983), *Discourse Analysis*. Cambridge University Press, Kembrixh.
- DECLECK, R. (1991), *Tense in English: Its Structure and Use in Discourse*. Routledge, Nju Jork.
- DIESEL, H. (2008), *Iconicity of Sequence: A Corpus-based Analysis of the Positioning of Temporal Adverbial Clauses in English*. Cognitive Linguistics, Vol.19/3, Walter de Gruyter, f.465-490.
- FORD, E. C. (2005), *Grammar in Interaction – Adverbial Clauses in American English Conversations*, Cambridge University Press.
- HAMM, A. (2001), *Towards a discourse-related typology of ambiguity*. Ranam, Special issue: Linguistic ambiguity. A. Hamm and P. Buccellato eds 34, ff. 29-41.
- HWANG, S.-J. (2000), *Multiple Functions of when-clauses in Discourse*. LACUS Forum XXVI, Alberta, ff. 455-466.
- JURAFSKY, D & MARTIN, J. H. (2006), *Speech and Language Processing: An Introduction to Natural Language Processing, Computational Linguistics and Speech Recognition*. Second Edition, Pearson Prentice Hall, Nju Xhersi.
- KAMP, H. & REYLE, U. (1993), *From Discourse to Logic*. Kluwer, Dordrecht.
- LLOSHI, XH. (2015), *Stilistika e Gjuhës Shqipe dhe Pragmatika*. Albas, Tiranë.
- LURAGHI, S. (1995), *The Pragmatics of Verb Initial Sentences in Some Ancient Indo-European Languages*, in *Word Order in Discourse*, Benjamins, Amsterdam.
- MILLER, J. (2006), *Clause Structure in Spoken Discourse*. Elsevier, ff. 481-483.

KORPUSI GJUHËSOR

British National Corpus. BNC XML Third Edition, Oxford University Computing Services, Oksford, 2007.

Corpus of Contemporary American English. Created by Mark Davies, Brigham Young University, Utah, 2012.